

KONKURS

Institucioni Privat i Arsimit Parauniversitar, **Horizon School Kosova** sh.p.k., i licencuar nga MASHTI me numër licence 3-1214, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe Statutin e shkollës, shpall konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2026/2027, si vijon:

➤ **Mirëmbajtës/e.....(2) pozita;**

Orari i punës: fleksibil.

1. Kualifikimet dhe kërkesat

- Përvojë paraprake në mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambienteve përbën përparësi;
- Njohuri bazë për përdorimin e mjeteve dhe produkteve të pastrimit;
- Gatishmëri për punë me orar fleksibil.

Përgjegjësitë kryesore

- Mirëmbajtja e pastërtisë dhe higjienës në ambientet e shkollës;
- Pastrimi dhe dezinfektimi i klasave, korridoreve, zyrave, nyjeve sanitare dhe hapësirave të përbashkëta;
- Përdorimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i mjeteve dhe produkteve të pastrimit;
- Raportimi me kohë i nevojave për furnizime ose i dëmtimeve të evidentuara;
- Respektimi i rregullave të higjienës, sigurisë dhe organizimit të brendshëm të shkollës.

Aftësitë dhe cilësitë personale

- Përgjegjësi, korrektësi dhe aftësi organizative;
- Aftësi për bashkëpunim në grup dhe komunikim të mirë;
- Besueshmëri dhe përkushtim ndaj standardeve të higjienës.

2. Mënyra e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e kërkuara në adresën elektronike **info@horizonschool-ks.com**.

- CV-në;
- Kopjen e dokumentit të identifikimit;
- Dëshmi për përvojën e punës, nëse posedojnë;
- Dokumente të tjera përcjellëse.

3. Shënim: Aplikimet kanë filluar dhe konkursi mbetet i hapur deri më datë 25.09.2026.